

MASTER

PROFESIONAL **60 ECTS** NË

MENAXHIM TURIZMI & HOTELERI



**TURIZMI NUK NDALET,
AS AMBICIET
E TUA!**

Kohëzgjatja: **2 semestre**
Gjuha: **Shqip - Anglisht**
Fakulteti i **Biznesit dhe Drejtësisë**

Skano
për më
shumë
info





Të dashur studentë,
Mirë se vini në Programin e Masterit
Profesional në Menaxhim Turizmi dhe Hoteleri
pranë Tirana Business University!
Ky program është projektuar për t'ju përgatitur
për rolet drejtuese dhe menaxheriale në

industrinë dinamike të turizmit dhe hotelerisë, duke
kombinuar në mënyrë të ekuilibruar njohuritë teorike me
aftësitë praktike. Përmes një kurrikule bashkëkohore dhe
ndërdisiplinore, ju do të mësoni si të menaxhoni me
sukses operacionet turistike, shërbimet hoteliere dhe
përvojat e klientëve në një treg global në zhvillim të
vazhdueshëm.

Programi ynë vendos theks të veçantë në integrimin e praktikave më të mira ndërkombëtare dhe trendeve më të fundit të industrisë, duke ju mundësuar t'i aplikoni menjëherë njohuritë në situata reale profesionale. Synimi ynë është t'ju ndihmojmë të zhvilloni aftësi kritike menaxheriale, mendim strategjik dhe kapacitete inovative — cilësi thelbësore për udhëheqjen me sukses në këtë sektor konkurrues.

Procesi mësimor do të udhëhiqet nga një ekip pedagogësh dhe profesionistësh të fushës, me përvojë të gjerë akademike dhe praktike në turizëm, hoteleri dhe menaxhim destinacionesh. Ata do t'ju ofrojnë mbështetje të vazhdueshme, duke ndarë me ju eksperiencën e tyre dhe duke ju udhëhequr në ndërtimin e një karriere të qëndrueshme e të suksesshme.

Gjithashtu, ky program do t'ju ofrojë mundësinë të ndërtoni një rrjet të vlefshëm profesional, që do të shërbejë si bazë për zhvillimin tuaj të mëtejshëm në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të turizmit.

Jemi të bindur se përvoja juaj në këtë master do të jetë një hap i rëndësishëm drejt suksesit tuaj profesional dhe do t'ju formojë si profesionistë të dalluar dhe liderë të së ardhmes në industrinë e turizmit dhe hotelerisë.

Me respekt,

Dr. Gerti Dajçi

Drejtore i Departamentit të Biznesit dhe Financës
Tirana Business University

PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT

Masteri Profesional në Menaxhim Turizmi dhe Hoteleri është zgjedhja ideale për ata që synojnë karrierë në një nga industritë më dinamike sot në botë. Programi ofron njohuri të thelluara dhe aftësi praktike për menaxhimin e suksesshëm të operacioneve turistike, hotelerisë dhe organizimit të eventeve.

Gjatë studimeve, do të mësoni të analizoni dhe zhvilloni strategji biznesi, të menaxhoni destinacione dhe përvoja unike për vizitorët, si dhe të përvetësoni teknikat më të fundit të marketingut dixhital dhe menaxhimit të burimeve njerëzore. Programi përgatit profesionistë të aftë për të përballuar sfidat e sektorit dhe për të krijuar mundësi të reja ndërmarrëse.

Nëse dëshironi të jeni lider në industrinë e turizmit dhe hotelerisë, ky master do t'ju pajisë me mjetet e nevojshme për një karrierë të suksesshme në një sektor me rritje të shpejtë dhe potencial të lartë global. Bashkohuni me ne dhe hapni dyert e mundësive të reja për të ardhmen tuaj!

AVANTAZHET KRYESORE NË PROGRAMIN MASTER PROFESIONAL NË “MENAXHIM TURIZMI DHE HOTELERIE” (60 ECTS):

- **FOKUS NË MENAXHIM STRATEGJIK**

Zhvillon aftësi për menaxhimin e niveleve të larta në industrinë e turizmit dhe hotelerisë.

- **KURRIKULË GJITHËPËRFSHIRËSE**

Balancë midis teorisë dhe praktikës, duke mbuluar menaxhimin operacional, eventet, marketingun dhe transformimin digjital.

- **INOVACION DHE TEKNOLOGJI**

Përqendrim në media sociale dhe zgjidhje kreative për përmirësimin e shërbimeve dhe marketingut.

- **PRAKTIKË E ZGJERUAR**

Përvojë profesionale e gjatë dhe e fokusuar në sektorët kyç të turizmit dhe hotelerisë.

- **MUNDËSI NDËRKOMBËTARE**

Lëndë të zgjedhura që ofrojnë mundësi studimi jashtë vendit dhe bashkëpunime me organizata të huaja.

- **RRJET PROFESIONAL DHE PUNËSIM**

Lidhje të forta me industrinë, duke ofruar mundësi punësimi reale pas diplomimit.

- **ANGAZHIM NË PROJEKTE PRESTIGJIOZE**

Mundësi për të punuar në projekte zhvillimi të rëndësishme nga BALFIN Group si ‘Green Coast’, ‘Vlora Marina’ etj. Brenda dhe jashtë vendit.

- **PËRGATITJE PËR ROLE DREJTUESE**

Formim për pozita menaxheriale në industrinë e turizmit dhe hotelerisë.

- **PËRVOJË PRAKTIKE DHE INTERSHIPE**

Eksperiencë direkte me kompanitë më të mëdha.

- **ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR**

Aftësi për të operuar në tregje globale dhe të avancuara.

- **LIDHJE PROFESIONALE**

Rrjetëzim me liderë të industrisë dhe punësim pas diplomimit.

- **ZHVILLIM I QËNDRUESHËM**

Formim për menaxhimin e projekteve turistike me fokus në qëndrueshmëri.

- **MARKETING DHE PROMOVIM**

Aftësi në përdorimin e kanaleve dixhitale për të rritur vizibilitetin e destinacioneve.

- **SIPËRMARRJE DHE INOVACION**

Formim për krijimin dhe menaxhimin e bizneseve të reja në turizëm.

- **MENAXHIM BURIMESH DHE SHËRBIMESH**

Aftësi për menaxhimin e stafit dhe optimizimin e operacioneve.

PERSPEKTIVAT E PUNËSIMIT

- **MENAXHER STRATEGJIE TURIZMI**

Zhvillimi dhe implementimi i strategjive për promovimin e destinacioneve turistike.

- **ANALIST I TREGUT & KONSULENT PËR DESTINACIONET**

Analizimi i tendencave dhe krijimi i projekteve të reja turistike.

- **MENAXHER OPERACIONESH NË HOTELE & RESTORANTE**

Menaxhimi i përditshëm i operacioneve dhe shërbimeve.

- **MENAXHER I BURIMEVE NJERËZORE**

Rekrutimi, trajnimi dhe motivimi i stafit në sektorin e turizmit.

- **MENAXHER MARKETINGU & PR**

Krijimi i strategjive të marketingut dhe komunikimit për destinacione dhe hotele.

- **KOORDINATOR EVENTESH**

Organizimi i ngjarjeve dhe eksperiencave turistike.

- **SIPËRMARRËS NË TURIZËM & HOTELERI**

Krijimi dhe menaxhimi i bizneseve të reja në sektor.

- **MENAXHER I INOVACIONIT & TRANSFORMIMIT DIGJITAL**

Zbatimi i teknologjive për përmirësimin e shërbimeve turistike.

- **SPECIALIST NË TURIZMIN KULTUROR & TË QËNDRUESHËM**

Promovimi dhe menaxhimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

SEKTORËT DHE KOMPANITË KU MUND TË PUNËSOHEN STUDENTËT:

1. Turizëm dhe Agjenci Turistikë
2. Hoteleri dhe Shërbime Mikpritëse
3. Marketing dhe Komunikim
4. Shërbime të Eventeve dhe Konferencave
5. Qeverisje dhe Politika Turistike
6. Dizajn dhe Teknologji për Turizmin dhe Hotelerinë
7. Këshillim dhe Edukim në Turizëm
8. Analizë dhe Kërkim në Turizëm
9. Trajtime dhe mësimdhënie në Menaxhim Operacional në Hoteleri - Turizëm

PSE TË ZGJIDHNI KËTË PROGRAM?

1. Përgatitje për një industri në zhvillim të shpejtë
2. Përfshirje e aspekteve të ndryshme të industrisë
3. Përgatitje e liderëve dhe sipërmarrësve të ardhshëm
4. Duke u fokusuar në qëndrueshmëri dhe zhvillim të destinacioneve
5. Mundësi për t'u angazhuar në tregje globale
6. Përvojë praktike dhe lidhje me industrinë
7. Zhvillim i aftësive për të udhëhequr në mjedisin digjital
8. Punësim në një sektor me rritje të shpejtë dhe kërkesë për profesionistë



METODA E

MËSIMDHËNIES

1

Mësimdhënie Teorike dhe e Specializuar:

Fokusohet në strategjinë e biznesit, analizën e tregut, menaxhimin e operacioneve dhe zhvillimin e destinacioneve turistike.

2

Studimi i Rasteve:

Analizimi i shembujve të menaxhimit të turizmit dhe hotelierisë nga kompani dhe destinacione të njohura, duke u njohur konkretisht me sfidat dhe zgjidhjet.

3

Simulimet dhe Praktika:

Përvojë praktike për studentët përmes simulimeve të menaxhimit të hoteleve, ngjarjeve dhe projekteve turistike.

4

Mësimdhënie Bazuar në Projekte:

Angazhimi në projekte reale, si 'Green Coast' apo 'Vlora Marina', për menaxhimin e turizmit dhe pasurive të patundshme.

5

Punë Praktike dhe Internship:

Mundësi për të aplikur njohuritë në mjedisë reale, duke zhvilluar aftësi praktike dhe lidhje profesionale.

6

Diskutime dhe Seminare:

Inkurajimi i mendimit kritik dhe analizës së thellë për tema të ndryshme.

7

Përdorimi i Teknologjisë dhe Mjeteve Dixhitale:

Përdorimi i sistemeve dhe mjeteve moderne për menaxhimin e turizmit dhe hotelierisë.

8

Mësimdhënie nga Profesionalistë të Industrisë:

Ligjërata dhe seminare nga profesionalistë të industrisë, për të sjellë eksperiencën praktike dhe zhvillimet e fundit.

9

Udhëtime Studimore dhe Vizita në Terren:

Vizita në destinacione turistike për të parë nga afër operacionet dhe menaxhimin e industrisë.

10

Mundësi Ndërkombëtare:

Bashkëpunim me universitete të huaja dhe mundësi për karrierë në tregje ndërkombëtare.

INFORMACION PRAKTIK

TË DHËNAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT



VEPRIMTARITË FORMUESE MASTER PROFESIONAL MENAXHIM TURIZMI & HOTELERIE 60 ECTS				
Kategoria	Tipi i komponentit mësimor		Lëndët	ECTS
A 1 lende	Lëndë Bazë (5-10%) (3-6 ECTS)	1.	English and Business Communication	5
			Total ECTS	5
B* 4 lende	Lëndët karakterizuese të Programit Master Profesional Menaxhim Turizmi dhe Hotelerie është (30-40%) (18 -24 ECTS)	1.	Strategic Business Analysis in Tourism and Hospitality	5
		2.	Event and Experience Design in Tourism	5
		3.	Tourism Business Forecasting and Project Development	5
		4.	Hotel and Restaurant Operations Management	5
			Total ECTS	20
C** 3 lende	Lëndë Ndërdisciplinore/ Integruese/ Profilizuese (20-30%) (12 - 18 ECTS)	1.	Digital Marketing and Social Media in Tourism and Events Management	6
		3.	Entrepreneurship in the Tourism, Events and Hospitality Industry	5
		4.	HR Management in Tourism	6
		5.	Digital Transformation in Tourism	5
		6.	Cultural Tourism	5
		7.	Managing Tourism Destination	5
			Total ECTS	17
D	Lëndë plotësuese (10%) (6 ECTS)		Temë diplome/Project	6
			Total ECTS	6
E	Detyrime Përmbyllese (10-20%) (6 - 12 ECTS)		Internship	12
			Total ECTS	12
Gjithsej 10 Lëndë			MASTER PROFESIONAL MENAXHIM TURIZMI DHE HOTELERIE Total ECTS	60

KËRKESAT E PRANIMIT:

- Diplomë Bachelor
- CV
- Dokument identifikimi

KONTAKTET:

☎ +355 69 70 66 966

🌐 www.tbu.edu.al

✉ info@tbu.edu.al

✉ admissions@tbu.edu.al

📍 Rr. “Rezervat e Shtetit”, Lundër, Tiranë, Shqipëri

📷 [tbu.edu.al](https://www.tbu.edu.al)

📘 Tirana Business University College

🌐 Tirana Business University College